**VENDIM**
**Nr. 427, datë 11.7.2018**

# PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE ZVOGËLIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 3.1 HA, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA "PIETRA NESLI" SHPK, PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT RANOR SILICOR NË OBJEKTIN "ZOGASI", BASHKIA SKRAPAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 3.1 ha, që do të përdoret nga shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit ranor silicor në objektin "Zogasi", Bashkia Skrapar, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor publik i bashkisë, të zvogëlohet në volum dhe të çregjistrohet nga Regjistri i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja nr. 1, me të dhënat për sipërfaqen pyjore që zvogëlohet në volum dhe hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor publik, si dhe harta topografike, me koordinatat e poligonit të sipërfaqes, objekt minerar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor, të produkteve të tjera pyjore e kullosore dhe të investimeve të kryera në vite në sipërfaqen, objekt minerar, të paguhen nga shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k., në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Skrapar, në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet sipas kushteve të lejes mjedisore dhe të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe pyjore prej 3.1 ha në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Bashkinë Skrapar.

4. Bashkia Skrapar dhe shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k., të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektin e miratuar për pyllëzimin, të dërgohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore sipas lidhjes 1 të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të bëjë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi nga kategoria "tokë e zënë pyjore" dhe ta regjistrojë në kategorinë "tokë e zënë, objekt i aktivitetit minerar".

7. Me përmbushjen e detyrimeve nga shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k., të përcaktuara në planin e rehabilitimit sipas lejes mjedisore, sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullosor publik të Bashkisë Skrapar.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Skrapar dhe shoqëria "Pietra Nesli" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Senida Mesi**

BASHKIA SKRAPAR

LISTA E NGASTRAVE DHE E N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQET PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR
TË SHOQËRISË "PIETRA NESLI" SHPK

| *Nr.* | *ID pronës* | *Ekonomia Pyjore / Kullosore* | *Ngastra n/ngastra* | *Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor/ kullosor HA* | *Përdorimi territorit* |
|---|---|---|---|---|---|
| *1* | *2* | *3* | *4* | *5* | *6* |
| | BR32 00 064a | Sijovë-Guhak | 64 a | 2.8 | shkurre |
| | BR32 00 064b | Sijovë-Guhak | 64 b | 0.3 | shkurre |
| **GJITHSEJ** | | | | **3.1** | |

# HARTA TOPOGRAFIKE

## ME KUFIRIN DHE KOORDINATAT E ZONES SE KERKUAR
## (*EKONOMIA PYJORE SIJOVE-GUHAK) SHKALLA 1:25000




PERGATITI

EMRI : ING.EDMOND SINJARI

LIC.T.0528/2, DT.18.1.2016

DATA E PERGATITJES
23 . 01. 2018

**SHENIME:**

- SIPERFAQIA E KERKUAR TOTALI 0.031KM²..
- EKONOMIA PYJORE SIJOVE - GUHAK..

- PAS. 89 a --SIP.0.028KM²
- PAS. 90 a --SIP.0.003KM²

TABELA E KOORDINATAVE

| PIKA | X | Y |
|---|---|---|
| 1 | 44 85 125 | 44 38 225 |
| 2 | 44 85 250 | 44 38 140 |
| 3 | 44 85 360 | 44 38 350 |
| 4 | 44 85 265 | 44 38 410 |